



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.18

Prishtinë, më 5.6.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla, Danush Ademi zëvendëskryetarë, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Kujtim Shala dhe Duda Balje.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues të OSBE-së Senad Karaahmetović dhe Smajl Demaj; përfaqësues të KDI-së Artan Murati dhe Riza Nushi. këshilltar i Sekretariatit të KKK-së Zijush Ahmeti, dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës të komisionit: Natasha Prica- Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së mbajtura të Komisionit më: 23.04.2018 dhe 3.05.2018;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamente të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale me amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim rajonal;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje me amendamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari, konstatoi se miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 23.04.2018 dhe 3.05.2018

Kryetari, konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 23.04.2018 dhe 3.05.2018, miratohen njëzëri, pa vërejtje.

Kryetari, në fillim e njoftoi komisionin se në vazhdimësi janë duke u përsëritur praktika e përhershme, nga se refuzohen amendamentet e propozuara nga GP të Listës serbe për çfarëdo arsye, madje edhe amendamentet që i takojnë kategorisë teknike, dhe për këto arsye Lista Serbe nuk do t'i votojë projektligjet e radhitura sipas këtij rendi të ditës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për, dhe 4 (katër) Kundër, dhe nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni konstatoi se Projektligji nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë.
- II. Përfaqësuesit e GP Lista serbe të përfaqësuar në strukturën e komisionit votuan kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për, dhe 4 (katër) Kundër, dhe nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni konstatoi se Projektligji nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë.
 - II. Përfaqësuesit e GP Lista serbe të përfaqësuar në strukturën e komisionit votuan kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.
- I.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për, dhe 4 (katër) Kundër, dhe nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni konstatoi se Projektligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë.
- II. Përfaqësuesit e GP Lista serbe të përfaqësuar në strukturën e komisionit votuan kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

1. Të ndryshme.

Xhelal Sveçla, ishte i mendimit se komisioni përveç shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, ka për obligim të jetë më aktivë në kryerjen e punëve që ndërlidhen me Planin e punës, të cilin e ka miratuar ky Komision.

Ai propozoi që Komisioni duhet ti planifikojë të realizohen vizita në terren, në disa rajone, me qëllim që të shohim për së afërmi vështirësitë dhe brengat me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës.

Kryetari, falënderoi kolegun për propozimin e dhënë nga se kjo çështje është në kompetencë të Komisionit, gjithmonë duke u bazuar në fushëveprimin dhe përgjegjësitë që dalin nga Plani i punës, i miratuar këtë vit. Theksoi se komisioni shqyrton dhe i procedon të gjitha ligjet në cilësinë e Komisionit Funkcional dhe aktivitetet tjera që ndërlidhen me planin e punës. Në fillim ishim në prije të kryhen zgjedhjet lokale që të dihet se kush është nikoqir në komuna. Pasi kjo çështje është definuar, së shpejti do të planifikohen vizitat në teren.

Anëtarët e komunitetit serbë do të paraqes listën me propozim të vizitave në komuna, posaçërisht komunat të cilat janë të banuara me komunitetin pakicë serbë. Jeni informuar me anë të mediave, se këtë vit kanë ndodhur disa sulme ndaj personave të caktuar dhe ndaj pasurisë së tyre, dhe këto janë arsye për të cilat do të kërkojmë t'ju ofrohet përkrahje në çfarëdo forme, me qëllim që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.

Ai hapi diskutimin lidhur me neglizhencën e Ministrisë të Punëve të Brendshme, i cili ende nuk iu është përgjigjur ftesës së komisionit, dhe kjo çështje ka mbetur e hapur për shqyrtim. Përkundër faktit si është proceduar zgjedhja e ministrit, ai ka obligim të vijë në Komision dhe të raportojë lidhur me çështjet aktuale.

Veçoi se është bërë shkelje procedurale për mënyrën e zëvendësimit të ministrit Gashi, zgjedhja e të cilit nuk është proceduar në formë të rregullt nga Kuvendi, dhe këtë temë do ta ngrisë si pikë të veçantë në Seancë Plenare.

Si çështje tjetër, e informoi Komisioni se partneri i OSBE-së ka propozuar të mbahet një takim i përbashkët lidhur me zbatimin e aktiviteteve të planit të punës, i miratuar nga ky komision.

Kryetari, konstaton se Komisioni do të mbaj një takim javën e ardhme, ku do të rishqyrtohet plani i punës dhe rezultatet e arritura për gjashtëmuajorin e dytë.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40.
Përgaditur nga stafi mbështetës i komisionit*

Kryetar i komisionit,

Igor Simiq